

Termet e Referencës për angazhimin e OSHC-ve në monitorim dhe mbikëqyrje të institucioneve lokale

(Project 2100971, aktiviteti 1.2: Lehtësimi i trajnimeve të OSHC-ve shtesë nga trajnuesit e certifikuar)

Informata të përgjithshme:

Në kuadër të projektit “Mbështetje për mekanizmat e pjesëmarrjes për monitorim dhe ndikim në proceset e vendimmarrjes”, Seksioni i Pjesëmarrjes Publike (SPP) që vepron në kuadër të Departamentit të Demokratizimit në Misionin e OSBE-së në Kosovë, synon t’i shtojë përpjekjet e pjesëmarrjes dhe avokimit të organizatave të shoqërisë civile (OSHC), grupeve të grave dhe të rinjve për të punuar me institucionet komunale dhe qendrore.

Në mënyrë të veçantë, projekti ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve, ofrimin e mjeteve dhe nxitjen e pronësisë për OSHC-të për të marrin pjesë në vendimmarrje dhe për të siguruar mbikëqyrje për punën e institucioneve përkatëse lokale. Në kuadër të këtij projekti, SPP do të mbështesë deri në tetë (8) **OSHC nga komunat e Kaçanikut/Kaçanik, Kamenicës/Kamenica, Hanit të Elezit/Elez Han, Štrpce/Shtërpcës, Podujevës/Podujevo, Glllogocit/Glllogovac, Zubin Potokut/Zubin Potok dhe Gračanica/Graçanicës për të përfitur nga trajnimet dhe për t’u angazhuar në monitorimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve komunale.**

Objektivi:

Objektivi i angazhimit të OSHC-ve në këtë projekt është ngritja e kapaciteteve të tyre në monitorimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve lokale

Detyrat:

Nën mentorimin e SPP, organizatat e përzgjedhura të shoqërisë civile do të:

1. Përgatisin të gjithë logjistikën dhe organizimin e trajnimeve (5+2 ditë, me mundësi të punëtorive shtesë)
2. Caktojnë katër (50% femra) anëtarë përkatës të stafit për të marrë pjesë në pesë trajnim të përgjithshëm njëditore dhe dy trajnime të avancuara njëditore dhe të bëjnë përpjekje që të hartojnë raporte cilësore për monitorim dhe mbikëqyrje të institucioneve lokale;
3. Plotësojnë gjashtë ushtrime të monitorimit dhe të raportojnë mbi të njëjtat bazuar në metodologjinë e trajnimit në një komunë të caktuar. Ushtrimet do të kryhen në tri seanca të kuvendit komunal dhe tri mbledhje të komiteteve të kuvendit komunal. Ushtrimi duhet t’i mbulojë kërkesat përkatëse gjinore;
4. Kryejnë së paku dy monitorime tjera të pavarura dhe aktivitete të mbikëqyrjes në institucione lokale;

5. Bashkëpunojë me strukturat komunale dhe mekanizmat ekzistues të pjesëmarrjes publike në nivelin lokal; bashkëbiseduesit brenda strukturave përkatëse komunale; bashkëbiseduesit e komunitetit përkatës, etj.

Në përmbushjen e detyrave, OSHC-të e përzgjedhura inkurajohen që të angazhohen me OSHC-të lokale aktive me bazë në komunitet në çështje të ndryshme në nivel komunal, si dhe në promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të burrave dhe grave në të gjitha aktivitetet.

Rezultatet e pritura:

Brenda fushëveprimit të këtij projekti, dhe në kuadër të bashkëpunimit me OSBE-në, OSHC-të e zgjedhura do të sigurojnë rezultatet në vijim, nën mbikëqytjen e përgjithshme të menaxherit të projektit:

- 1) Brenda *dy (2) muajsh* pas përzgjedhjes, çdo OSHC do të ketë konfirmuar një listë përfundimtare të pjesëmarrësve profesionalë përkatës të zotuar për përzgjedhje dhe interesimin për trajnim.
- 2) Brenda *dy (2) muajsh*, do të ketë përgatitur të gjitha çështjet logjistike dhe organizative në bashkëpunim me menaxherin e projektit të OSBE-së
- 3) Brenda *tre (3) muajsh*, do të jetë realizuar trajnimet (dhe potencialisht punëtoritë);
- 4) Brenda *tre (4) muajsh*, do të jetë dorëzuar raporti mbi monitorimin e komunave.
- 5) Në *nëntor 2016*, OSHC-të do t'i kenë prezantuar gjetjet e tyre në ngjarjen përfundimtare të projektit.

Kohëzgjatja:

Kohëzgjatja është nga 1 gusht deri 1 nëntor 2016

Treguesit e performancës:

Bazuar në detyrat e ndërmarra nga çdo OSHC, rezultatet dhe afatet e parapara, treguesit vijues të performancës duhet të arrihen:

- Çdo OSHC angazhon palët përkatëse të interesit dhe kryen monitorim të ndjeshëm gjinor dhe të moshës;
- Të gjitha materialet e nevojshme janë përgatitur në kohë dhe janë rënë dakord me OSBE-në;
- Takimet janë planifikuar me rregull, dhe shpërndahen informata të rregullta mbi risitë e mundshme (siç përcaktohet me planin e aktiviteteve) tek palët e interesit (duke përfshirë pikat e kontaktit të mentorimit në terren);
- Gjetjet dhe rekomandimet për veprime të mëtejshme janë paraqitur në ngjarjen përfundimtare të projektit.

Lokacioni:

Projekti i propozuar do të jetë me fokus në komunat në vijim: Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Hani i Elezit/Elez Han, Štrpce/Shtërpçë, Podujevë/Podujevo, Glllogoc/Glogovac, Zubin Potok/Zubin Potok dhe Gračanica/Gračanicë

Kriteret e Pranueshmërisë

- Vetëm OSHC-të e regjistruara zyrtarisht kanë të drejtë të aplikojnë për këtë skemë të projekteve të vogla.
-

- Projekti duhet të jetë i ndërlidhur me temën e identifikuar në këta Terma të Referencës dhe të mos ngërthejë shumë tema përnjëherësh;
- Projekti duhet të sigurojë integrimin e çështjeve gjinore në kuadër të temës së synuar;
- Projekti nuk duhet të dyfishojë një përpjekje tjetër ekzistuese që është në vazhdim e sipër. Në veçanti, i njëjti projekt nuk mund të mbështetet nga disa organizata;
- Projekti dhe të gjitha dokumentet shoqëruese duhet të dorëzohen në gjuhën angleze;
- Deklarata e misionit të OSHC-së duhet të jetë në pajtim me mandatin e Misionit të OSBE-së në Kosovë.

Buxheti:

Buxheti për projektet duhet të jetë midis 500 – 1,000 euro. Buxheti i projektit duhet të përfshijë vetëm shpenzimet që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet (**jo kostot e stafit**) që do të menaxhohen drejtpërdrejt dhe do të blihen financiarisht nga OSBE-ja.

Si të aplikoni:

- Projekt-propozimi (më së shumti 5 faqe), duke përfshirë a) objektivat dhe rezultatet që do të arrihen, b) qasjen dhe metodologjinë që do të aplikohet, c) planin e aktiviteteve, dhe d) mjetet e vlerësimit/raportimit
- Buxheti i detajuar i projektit
- CV-të e anëtarëve të propozuar të ekipit të projektit
- Historia e projekteve të zbatuara (më së shumti 1 faqe)
- Kopja e certifikatës së regjistrimit
- Aprovimi/marrëveshja nga komuna

Për informata të mëtejme ju lutem kontaktoni me z. Fitim Xharra, Departamenti i Demokratizimit, Misioni i OSBE-së në Kosovë, në adresën fitim.xharra@osce.org apo telefonin 038/240100, lokali 1154.
